



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Nr 4043/ Prot

Fushe-Arrez, me 24.12.2025



RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 43 datë 22/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Mbi miratimin e objekteve prioritare per investime per vitin 2026 e ne vazhdim"

Analiza ligjore: Mbështetet në ligjin Nr, 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 15 pika 1, neni 16 pika 1, neni 23 pikat 1,2,3,4,5,9,11,13,14, neni 27 pika 1 dhe 5, neni 55 pika 2 dhe 6, neni 64 pika "c", neni 66 pika "e", ligjin Nr 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 21, ligjin Nr 115/2014 date. 31/07/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale", VKM Nr 1096 datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Rregullave, Kushteve, Proçedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirave Publike", neni 7, Ligjin Nr 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Vkm Nr 686 date 22.11.2017 "Per Miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit", i ndryshuar, neni 53.

Situata aktuale e funksionit: 1-Rigjenerim i pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz, në kuadër të rritjes së efijences së energjisë, projekt ne vazhdim

2-Ndertim i nje qendre multifunksionale ne truallin e ish fabrikes se fibres ne Fushe-Arrez (Qender kulturore, biblioteke, godine per shtresat ne nevoje, qender sociale per moshen e trete, vendqendrim per mjetet e linjave te ndryshme, vendparkim). ne fazen e perfundimit te projekt/preventivit te zbatimit.

3-Perfundim i mureve mbajtes te qytetit Fushe-Arrez dhe shkalleve lidhese te tyre (faza e fundit) me vlere 48 109 808 leke.

4-Mbrojtje lumore dhe perforcim i truallit te objektit Godina e tregut ne qytetin Fushe-Arrez, me vlere te projektit te zbatimit prej 57 517 380 leke.

5-Shëndërimi i Tregut të Qytetit në Godinë për Bashkinë Fushë-Arrëz. (vlera e projektit të zbatimit është 55,704,408 leke), në fazë të ripërpunimit të preventivit të punimeve për shkak të ndryshimit të çmimeve.

6-Mbyllje (Rehabilitim i mbetjeve urbane), venddepozitimi Kthesa e Krrabit me vlerë të projektit të zbatimit 35,022,100 leke.

7-Blerje kazane për administrimin e mbetjeve jetesore, në sasinë prej 70 cope dhe kapacitet 1.1m³, në funksion të shtrirjes së shërbimit edhe në zonën periferike të qytetit Fushe-Arrez dhe fshatrave përreth si dhe në Njësia Administrative.

8-Gjellbërime dhe rrethim i varrezave publike të qytetit Fushë-Arrëz, (vlera e projektit 18,806,550 leke)

9-Gjellbërime dhe rrethim i varrezave publike të fshatit Flet Njësia Administrative Blerim.

10-Zgjerim sipërfaqeje, gjellbërime dhe rrethim i varrezave publike në fshatin Kryezi (lagjia Kodra e Geges).

11-Gjellbërime dhe rrethim i varrezave publike në fshatrat Gralisht, Bugjon dhe Kokdode Njësia Administrative Fierze.

12-Ndërtim i rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Kryezi.

13-Rikonstruktion i plote i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe ndërtim i impiantit të trajtimit të tyre në qytetin Fushe-Arrez dhe fshatrat Fushe-Arrez dhe Kryezi.

14-Rikonstruktion i shkollës Fillore Fushe-Arrez si qendër komunitare në pritje financimi.

II-RRUGE+URA AUTO+URA TË VARURA

1-Ndërhyrje emergjente në rrugën auto-rurale Bardhet -Iballë me vlerë të projektit të zbatimit prej 36,485,908 lek me tvsh.

2-Sistemim Asfaltim i rrugës auto urbane lagjia Nushaj qytetin Fushë-Arrëz në fazën e hartimit të projek/preventivit të zbatimit, pas ndryshimeve me kërkesë të banorëve përfitues.

3-Sistemim+asfaltim i rrugës auto-rurale për fshatrat Micoj dhe Lumardh+zgjatim segmenti për lagjet Gegaj -Prrez, në fazë hartimi të projektit të zbatimit.

4-Rikonstruktion i plotë i rrugës auto-rurale fshati Mzi (vlera e projektit 107,520,625 lekë), në fazë të ripërpunimit të preventivit të punimeve për shkak të ndryshimit të çmimeve.

5- Rikonstruktion i rrugës auto-rurale lagjia Bardhet, Njësia Administrative Qafë-Mali (vlera e projektit 10,669,703 lekë), në fazë të ripërpunimit të preventivit të punimeve për shkak të ndryshimit të çmimeve.

6-Sistemim +asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në fshatrat Kryezi, Orosh (degëzimet nga aksi kryesor Bardhet-Iballë në drejtim të lagjeve).

7-Sistemim +asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në fshatin Qafë-Mali (degëzimet nga aksi kryesor Bardhet Qafë-Mali për lagjet Palucaj, Marenaj, Vasiaj, Likaj, Jakaj.

8-Sistemim+asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në Njësinë Administrative Fierze (degëzimet nga aksi kryesor Fushë-Arrëz-Fierzë), si dhe rrugë të brendshme auto-rurale të fshatit Fierzë.

9-Rikonstruksion rruges auto-rurale Bugjon-Gralisht Njesia Administrative Fierze +ure auto ne perroin Bugjon.

10-Hapje traseje te re (segmenti rrugor auto-rural Fierze Apripë Guri), Njësia Administrative Fierzë, (vlera e projektit 111,177,692 lekë), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.

11-Hapje degezim te ri rruge auto rurale lagjia Kolgjokaj fshati Dardhe Njesia Administrative Blerim.

12-Rikonstruksion rruga auto rurale lagjia Nderlymna, Njesia Administrative Iballe.

13-Hapje rruge te re qe lidh Njesite Administrative Iballe dhe Fierze,

14-Riparim i plote i ures pasarele ne fshatin Levoshe, Njesia Administrative Iballe.

15- Riparim i plote i ures auto perroji Sylajve fshati Flet.

III-UJËSJELLËSAT

1-Ndërtim i ujësjellësit të ri në fshatin Kryezi me vlere te projektit 145,994,014 leke), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.

2-Rikonstruksione të pjesshme në rrjetet e shpërndarjës në ujësjellësat e fshatrave Truen, Qebik, Flet, Blerim, Kulumri dhe Xath, Njësia Administrative Blerim.

3-Ndërtim ujesjellesi ri në fshatrat Mzi, Gralisht dhe Fierzë dhe rikonstruksion i pjesshem i ujesjellesit në fshatin Porav, Njësia Administrative Fierzë.

4-Ndertim ujesjellesi te ri ne fshatin Shopel, Njesia Administrative Iballe.

5-Perfundim i Ujesjellesit Gere Qender fshati Iballe(faza e dyte, depo+rrjeti shperndares+mates uji), Njesia Administrative Iballe.

IV-VEPRA VADITËSE

1-Permiresim i infrastruktures se vaditjen ne fshatin Fushe-Arrez(kanali ujitës Micoj-Dedaj-Marinaj kanali ujites Micoj -Nushaj), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve dhe shtese projekti per lagjen Nushaj.

2-Rikonstruksion i pjesshem në kanalin vaditës në fshatin Mzi (linja kryesore e furnizimit deri tek rrjeti i shperndarjes), Njësia Administrative Fierzë

3-Rikonstruksione të pjesshme në kanalet vaditëse në fshatrat Bugjon dhe Arst, Njësia Administrative Fierzë.

4-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës në fshatin Kryezi (Mardodaj -Miriaj Palushaj), Njesia Administrative Qafë-Mali.

5- Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës në fshatin Qafë-Mali(lagjia Likaj-Marenaj), Njesia Administrative Qafë-Mali.

7-Rikonstruksione të pjesshme në kanalet vaditëse në fshatrat, Truen dhe Qebik, Njësia Administrative Blerim.

8-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës Gere, në fshatin Iballe, Njesia Administrative Iballe.

9-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës "Vada e Zhupit", në fshatin Berishe, Njesia Administrative Iballe.

10-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës Arifaj në fshatin Kryezi, Njesia

11-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës në fshatin Gralisht, Njesia Administrative Fierze.

12-Rikonstruksion i kanalit vadites Dervish-Brahaj, fshati Kryezi, Njesia Administrative Qafe-Mali.

13-Rikonstruksion i kanalit vadites perroji Orosh- Qender, fshati Kryezi, Njesia Administrative Qafe-Mali.

V-SHËNDETËSIA

1-Rikonstruksion i Qendres Shendetesore Fushe-Arrez.

2-Rikonstruksion i plotë Qendrës Shëndetësore ne Njesinë Administrative Fierze (me vlere projekti 4,000,000 leke).

3-Rikonstruksione të pjesshme të Qendrave Shëndetësore në fshatrat Porav, Apripë-Guri, të Njesisë Administrative Fierzë.

4-Ndërtim Ambulance tip A-2 në fshatin Bugjon, të Njesisë Administrative Fierzë.

5-Rikonstruksione te plota te qendrave shendetesore ne fshatrat, Xath, Flet, Dardhe, Njesia Administartive Blerim.

VI-ARSIMI

1-Rikonstruksion i plote i shkolles 9-vjeçare ne fshatin Dardhe, Njesia Administrative Blerim, vlere e projektit te zbatimit eshte 13,759,296 leke.

2-Rikonstruksione të pjeshme në shkollat 9-vjeçare Porav, Arst-Miliska, Njesia Administrative Fierzë.

3/1 Rikonstruksione të pjeshme në shkollat 9-vjeçare Bugjon, Njesia Administrative Fierzë.

3/2-Ndertim i nje godine te re per shkollen 9-vjeçare te fshatit Bugjon Njesia Administrative Fierzë.

4-Rikonstruksion i anekseve të shkollave 9-vjeçare në fshatrat Berishë e Epër dhe Mërtur, Njësia Administrative Iballë.

5-Rikonstruksione te pjeshme ne shkollat 9-vjeçare te fshatrave, Truen, Flet, Njesia Administrative Blerim.

VII-PYJET DHE KULLOTAT

1-Hartim i planeve te menaxhimit dhe mbareshtimit per te gjitha ekonomite pyjore te Bashkise Fushe-Arrez.

2-Pyllezim ne zonat e djegura, te degraduara dhe te eroduara.

3-Ndertim te sistemeve te pritave malore per mbrojtje nga erozioni.

VIII-SHERBIMI ZJARRFIKES DHE SHPETIMI

1-Pajisja e Sherbimit Zjarrfikes dhe Shpetimit me mjetet e nevojshme logjistike per kryerje e detyrave funksionale

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Investimeve ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtorinë Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Investimeve për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Prioritetet e investimeve per vitin 2026 impaktojne jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkise.

Per hartimin e listes se prioriteteve jane mbajtur degjesa publike ne njesite administrative.

Komisioni i Përhershëm për “ Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 24/12/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 43 datë 22/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Mbi miratimin e objekteve prioritare per investime per vitin 2026 e ne vazhdim" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Frane Doda  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Benjona Marku  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 4043 Prot.

Fushe-Arrez, me 24.12.2025

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

**Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare
Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit mbi shqyrtimin e
projektvendimit per MIRATIMIN E OBJEKTEVE PRIORITARE PËR INVESTIME PËR
VITIN 2026 E NË VAZHDIM.**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mbledh Komisioni i Ekonomise Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit te Zhvillimit Strategjik, ditën e mërkurë, datë 24.12.2025, ora 9:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, ku u mor ne shqyrtim projektvendimin per MIRATIMIN E OBJEKTEVE PRIORITARE PËR INVESTIME PËR VITIN 2026 E NË VAZHDIM. Gjithashtu i pranishem ishte, Drejtori I Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit Ing. Tonin PRENGA, i cili dha shpjegime per projektin qe do te shqyrtohet ne mbledhjen e Komisionit te dates 24.12.2025.

Anetaret e Komisionit ,jane njohur me pare me projektin dhe relacionin e sektorit perkates , ndersa ne mbledhje jane njohur me projektin dhe relacionin kane degjuar shpjegimet e Z.Tonin Prenga te cilat konsistuan ne proceduren e ndjekur ne hartimin e prorioiteteve te investimeve te bashkise ne vepra publike per vitin 2026, duke nisur me njoftimin e administratoreve per organizimin e konsultimit me kryetaret e fshatrave ,banoret dhe grupet e interesit, hartimin e listes duke i renditur sipas ,rendesise, emergjences etj. Diskutimi ne bashki dhe hartimi i materialit per gjithë bashkine duke mbajtur ne konsiderate edhe rekomandimet e dala ne konsultimin publik per buxhetin e vitit 2026.

Pergjegjesi Sektorit te Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit Ing. Tonin PRENGA,

shpjegoi se bashkelidhur projektvendimit gjendet nje liste e objekteve prioritare per investime te ndara sipas llojit dhe funksionit e cila eshte e ndare ne TETE KAPITUJ:

I-PROJEKTE TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

II-RRUGE+URA AUTO+URA TE VARURA ; III-UJËSJELLËSAT

IV-VEPRA VADITËS; V-SHËNDETËSIA; VI-ARSIMI

VIII-PYJET DHE KULLOTAT; IX-SHERBIMI ZJARRFIKES DHE SHPETIMI

ku u listua secili prej tyre.

1-Rigjenerim i pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz, në kuadër te rritjes së efijences së energjisë, projekt ne vazhdim

2-Ndertim i nje qendre multifunksionale ne truallin e ish fabrikes se fibres ne Fushe-Arrez(Qender kulturore, biblioteke, godine per shtresat ne nevoje, qender sociale per moshen e trete, vendqendrim per mjetet e linjave te ndryshme, vendparkim). ne fazen e perfundimit te projekt/preventivit te zbatimit.

3-Perfundim i mureve mbajtes te qytetit Fushe-Arrez dhe shkalleve lidhese te tyre (faza e fundit) me vlere 48 109 808 leke.

4-Mbrojtje lumore dhe perforcim i truallit te objektit Godina e tregut ne qytetin Fushe-Arrez, me vlere te projektit te zbatimit prej 57 517 380 leke.

5-Shëndërrimi i Tregut të Qytetit në Godinë për Bashkinë Fushë-Arrëz. (vlere e projektit te zbatimit eshte 55,704,408 leke), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.

6-Mbyllje (Rehabilitim i mbetjeve urbane) ,venddepozitimi Kthesa e Krrabit me vlere te projektit te zbatimit 35,022,100 leke.

7-Blerje kazane per administrimin e mbetjeve jetesore,ne sasine prej 70 cope dhe kapacitet 1.1m³, ne funksion se shtrirjes se sherbimit edhe ne zonen periferike te qytetit Fushe-Arrez dhe fshatrave perreth si dhe ne Njesite Administrative.

8-Gjelbërim dhe rrethim i varrezave publike të qytetit Fushë-Arrëz, (vlere e projektit 18,806,550 leke).

9-Gjelbërim dhe rrethim i varrezave publike të fshatit Flet Njesia Administrative Blerim.

10-Zgjerim siperfaqeje, gjelbërim dhe rrethim i varrezave publike ne fshatin Kryezi(lagjia Kodra e Geges).

11-Gjelbërim dhe rrethim i varrezave publike ne fshatrat Gralisht, Bugjon dhe Kokdode Njesia Administrative Fierze.

12-Ndertim i rrjetit te ndriçimit publik ne fshatit Kryezi.

13-Rikonstruksion i plote i rrjetit te kanalizimeve te ujerave te perdorura dhe ndertim i impiantit te trajtimit te tyre ne qytetin Fushe-Arrez dhe fshatrat Fushe-Arrez dhe Kryezi.

14-Rikonstruksion i shkolles Fillore Fushe-Arrez si qender komunitare ne pritje financimi.

Anetaret e komisionit rane dakort me projektin e paraqitur duke kerkuar qe ne vendim te perfshihen edhe propozimet qe do dalin ne mbledhjen plenare te keshillit nga ana e keshilltareve dhe subjekteve te tjera te interesuara.

Me shumice votash Komisioni i propozon Keshillit qe te miratoje projektin e paraqitur nga administrata duke perfshire edhe propozimet qe do te paraqiten ne mbledhjen plenare te Keshillit te dates 26.12.2025.

PER KOMISIONIN

Beniana Morila
Bj

Franc DODA

[Signature]

Zgjerim
Kryezi!

Valentina Heshaj
H